05/03/2026

Raporti I Ngjarjeve, 5 Mars 2026

Policia e Shtetit/Vijon operacioni ndërkombëtar i koduar "The Wanted", për lokalizimin, kapjen dhe ekstradimin e shtetasve në kërkim ndërkombëtar.

Ekstradohet nga Mbretëria e Bashkuar, 1 shtetas që akuzohet se ka siguruar mjete dhe kushte për vrasjen e një shtetasi, në vitin 2021, në fshatin Gjocaj, Peqin.

Si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet specialistëve të Interpol Tiranës dhe homologëve në Mbretërinë e Bashkuar, në kuadër të operacionit ndërkombëtar të koduar "The Wanted", u finalizuan procedurat për ekstradimin në Shqipëri, të shtetasit:

-L. L. alias K. L. alias I. L., 49 vjeç, lindur në Lushnjë.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin e datës 01.10.2023, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vrasja për gjakmarrje", "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasjet", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal dhe organizata kriminale".

49-vjeçari dyshohet se ka bashkëpunuar me shtetasit L. H., A. T., L. S., E. Xh. dhe B. B., për të kryer vrasjen e shtetasit A. B., më datë 27.12.2021, në fshatin Gjocaj, Peqin.

Ai dyshohet se ka siguruar armët për kryerjen e këtij krimi dhe mjetet e transportit për largimin e ejesëtarëve të tjerë të grupit kriminal, nga vendi i ngjarjes.

Vlorë / Vijon puna për kapjen dhe ndalimin e shtetasve të shpallur në kërkim

Kapet një shtetas i shpallur në kërkim për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Vlorë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, si dhe për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, bënë të mundur lokalizimin, kapjen dhe ndalimin e shtetasit:

-B.B., 37 vjeç, banues në Vlorë.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me datë 13.01.2026, i kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

Nga hetimet intensive, të zhvilluara përgjatë disa muajve dhe me përdorimin e metodave speciale të hetimit, u dokumentua se më datë 11.11.2025, në orët e para të mëngjesit, në lagjen "28 Nëntori", në Vlorë, 37-vjeçari ka djegur katin e parë të një subjekti privat.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë Vlorë për veprime të mëtejshme

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër

Specialistët e Sektorit të Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasin S. D., 38 vjeç, banues në fshatin Dobraç, pasi u kap duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shkodër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin Gj. M., 37 vjeç, pasi ka kryer punime ndërtimi pa leje.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar "Kontrata".

Ekzekutohen masa sigurie për 5 shtetas, të akuzuar për falsifikim dokumentesh ose shpërdorim të detyrave.

Vendoset sekuestro preventive mbi një sipërfaqe toke në fshatin Mëzez, që është përfituar në mënyrë të paligjshme nga 2 prej këtyre shtetasve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, organizuan dhe finalizuan në drejtimin e Prokurorisë, operacionin e koduar "Kontrata", në kuadër të të cilit u ekzekutua vendimi i datës 03.03.2026, i Gjykatës së Tiranës, që ka caktuar masat e sigurisë për 5 shtetas, si vijon:

-"Arrest në burg", për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", për shtetasin D. B., 45 vjeç;

-"Arrest në shtëpi", për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", për shtetasin I. Ç., 59 vjeç;

-"Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", kryer në bashkëpunim, për shtetasit B. S., 49 vjeç, F. Z., 35 vjeç dhe Th. L., 41 vjeç, punonjës në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Nga hetimet dyshohet se shtetasit D. B. dhe I. Ç. kanë kaluar në pronësi të tyre një sipërfaqe toke 2350 m² në fshatin Mëzez, që ishte pronësi të një shtetasi tjetër, nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, në bashkëpunim me 3 punonjësit e ASHK-së.

Më tej, Gjykata ka caktuar sekuestro preventive për këtë sipërfaqe toke.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin M. N., 28 vjeç, banues në Laç, pasi dyshohet se në bashkëpunim me një shtetas tjetër ende të paidentifikuar, janë konfiskuar me një 35-vjeçare, për shkak të manovrimit të gabuar në rrugë me automjet.

Vijon puna për kapjen e shtetasit në kërkim, identifikimin e bashkëpunëtorit të tij dhe për zbardhjen e rrethanave të rastit.

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin S. L., 54 vjeç, banues në Laç, pasi në banesën e tij u konstatua lidhje e paligjshme e energjisë elektrike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin Gj. R., 25 vjeç, banues në Laç, pasi me automjetin që kishte parkuar në mënyrë të parregullt, në qytetin e Lezhës, ka penguar kalimin e automjeteve të tjera.

Shërbimet e Policisë Rrugore Lezhë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin E. X., 34 vjeç, banues në Mamurras, pasi u kap duke drejtuar pa leje drejtimi, një motomjet pa targë.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

DVP Dibër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Mat referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal ndaj shtetasve E.S., 51 vjeç; H.A., 32 vjeç; B.K., 50 vjeç; L.K., 49 vjeç; A.T., 36 vjeç, banues në Klos, pasi me vetëgjyqësi u kanë bllokuar rrugën punonjësve të një shoqërie private, me qëllim moslejimin e vijimit të punimeve për ndërtimin e një HEC-i në fshatin Kurdari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Dibër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A.P., 61 vjeç, banues në fshatin Luzni, pasi për motive të dobëta ka kanosur me fjalë shtetasin Dh.P.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për veprime të mëtejshme.

Vlorë / Vijojnë goditjet kundër armëmbajtjes pa leje dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.

Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 25-vjeçari ndë një shtetas tjetër për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen armë zjarri (pistoletë), municion luftarak, lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, maskë plastike, 4 aparate celularë dhe një automjet.

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin S. L., 54 vjeç, banues në Laç, pasi në banesën e tij u konstatua lidhje e paligjshme e energjisë elektrike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin Gj. R., 25 vjeç, banues në Laç, pasi me automjetin që kishte parkuar në mënyrë të parregullt, në qytetin e Lezhës, ka penguar kalimin e automjeteve të tjera.

Shërbimet e Policisë Rrugore Lezhë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin E. X., 34 vjeç, banues në Mamurras, pasi u kap duke drejtuar pa leje drejtimi, një motomjet pa targë.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

DVP Dibër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Mat referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal ndaj shtetasve E.S., 51 vjeç; H.A., 32 vjeç; B.K., 50 vjeç; L.K., 49 vjeç; A.T., 36 vjeç, banues në Klos, pasi me vetëgjyqësi u kanë bllokuar rrugën punonjësve të një shoqërie private, me qëllim moslejimin e vijimit të punimeve për ndërtimin e një HEC-i në fshatin Kurdari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Dibër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A.P., 61 vjeç, banues në fshatin Luzni, pasi për motive të dobëta ka kanosur me fjalë shtetasin Dh.P.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për veprime të mëtejshme.

Vlorë / Vijojnë goditjet kundër armëmbajtjes pa leje dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.

Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 25-vjeçari ndë një shtetas tjetër për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen armë zjarri (pistoletë), municion luftarak, lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, maskë plastike, 4 aparate celularë dhe një automjet.

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin S. L., 54 vjeç, banues në Laç, pasi në banesën e tij u konstatua lidhje e paligjshme e energjisë elektrike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin Gj. R., 25 vjeç, banues në Laç, pasi me automjetin që kishte parkuar në mënyrë të parregullt, në qytetin e Lezhës, ka penguar kalimin e automjeteve të tjera.

Shërbimet e Policisë Rrugore Lezhë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin E. X., 34 vjeç, banues në Mamurras, pasi u kap duke drejtuar pa leje drejtimi, një motomjet pa targë.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

DVP Dibër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Mat referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal ndaj shtetasve E.S., 51 vjeç; H.A., 32 vjeç; B.K., 50 vjeç; L.K., 49 vjeç; A.T., 36 vjeç, banues në Klos, pasi me vetëgjyqësi u kanë bllokuar rrugën punonjësve të një shoqërie private, me qëllim moslejimin e vijimit të punimeve për ndërtimin e një HEC-i në fshatin Kurdari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Dibër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A.P., 61 vjeç, banues në fshatin Luzni, pasi për motive të dobëta ka kanosur me fjalë shtetasin Dh.P.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për veprime të mëtejshme.

Vlorë / Vijojnë goditjet kundër armëmbajtjes pa leje dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.

Qarkullonte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 25-vjeçari ndë një shtetas tjetër për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen armë zjarri (pistoletë), municion luftarak, lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa, maskë plastike, 4 aparate celularë dhe një automjet.

Shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në DVP Vlorë në bashkëpunim edhe me Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Vlorë, në vijim të kontrolleve për kapjen e personave që qarkullonjnë me armë zjarri dhe bazuar edhe në informacionet e siguruara në rrugë operative, kanë ndaluar për kontroll një automjet tip "Benz", në rrethrrotullimin e bypass-it, në fshatin Babicë e Madhe.

Automjeti drejtohej nga shtetasi F.H., 25 vjeç, banues në Vlorë, ndërsa pasagjer ishte shtetasi D.A., 25 vjeç, banues në Vlorë.

Gjatë kontrollit fizik ndaj shtetasit F.H., në çantën e tij marsup iu gjet dhe sekuestrua një armë zjarri (pistoletë) me një krehër me 5 fishekë.

Në vijim të veprimeve procedurale, gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi u gjetën dhe u sekuestruan 20 fishekë luftarakë, një sasi lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa si dhe një maskë plastike.

Gjithashtu, në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 4 aparate celularë dhe automjeti i këtij shtetasi.

Në përfundim të veprimeve procedurale:

u arrestuan shtetasit

-F.H., për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve",

-D.A., për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Vlorës, vijojnë hetimet për këta shtetas, si dhe për verifikimin e përfshirjes së tyre të mundshme në ngjarje të tjera kriminale.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier ekzekutuan vendimin e Gjykatës së Fierit e cila ka caktuar dënimin me 5 vite burg për shtetasen L. Z., 57 vjeçe, banuese në Elbasan, për veprën penale "Mashtrimi".

Specialistët e Qarkullimit Rrugor të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin D. Z., 23 vjeç, banues në fshatin Matian, Lushnjë, pasi duke drejtuar një motomjet pa targa, është përfshirë në një aksident me një automjet. Si pasojë është dëmtuar drejtuesi i motorjetit, shtetasi D. Z., dhe një pasagjer që ndodhej në motomjet, të cilët ndodhen në spital për ndihmë mjekësore, jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë së Fierit për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Gjirokastër referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasen V. D., 54 vjeçe, banuese në Memaliaj, pasi dyshohet se ka kanosur me fjalë, për motive të dobëta, shtetasin S. D., 54 vjeç, banues në Gjirokastër.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Përmet referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:

-J. T., banues në fshatin Stërmbec, pasi dje, ka penguar punonjësit e bashkisë, gjatë punës për rregullimin e shtyllave të ndriçimit. Gjatë kontrollit në banesën e tij, shërbimet e Policisë konstatuan lidhje të paligjshme të energjisë elektrike,

-V. M., 47 vjeç, pasi u konstatua duke kryer punime ndërtimi, pa lejen përkatëse.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Staceionit të Policisë Dropull-Libohovë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit F. M., 39 vjeç, banues në fshatin Dervician dhe Xh. D., 40 vjeç, banues në Gjirokastër, pasi dyshohet se janë konfliktuar fizikisht dhe me sende të forta me njëri-tjetrin, për motive të dobëta.

Materialet procedurale ju referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

Librazhd

Plagosi me thikë, një 46-vjeçar, gjatë një konflikti për motive të dobëta, vihet në pranga.

Vihet në pranga dhe një 48-vjeçar, pasi dyshohet se ka fshehur thikën dhe nuk ka njoftuar Policinë, për ngjarjen.

Procedohen penalisht bashkëshortja e 48-vjeçarit, e cila dyshohet ka bashkëpunuar për të fshehur thikën e përdorur për plagosjen, dhe shtetasi i dëmtuar, pasi të dy kanë refuzuar të japin informacione për rrethanat e ngjarjes.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Librazhd, menjëherë pas njoftimit për konfliktin e ndodhur mbrëmjen e djeshme, në afërsi të urës së qytetit të Librazhdit, organizuan punën për zbardhjen e rrethanave dhe identifikimin e shtetasve të përfshirë.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore, u bë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:

-H. D., 75 vjeç, banues në Librazhd, për veprën penale "Plagosja e rëndë me dashje",

-A. H., 48 vjeç, banues në Librazhd, për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës".

Nga hetimet dyshohet se më datë 04.03.2026, rreth orës 20:20, gjatë një konflikti për motive të dobëta, shtetasi H. D. ka goditur me mjet prerës (thikë), shtetasin S. M., 46 vjeç, banues në Librazhd, i cili është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Shtetasi A. H. dyshohet se ka fshehur mjetin prerës me të cilin është kryer plagosja, si dhe nuk ka raportuar në Polici, për ngjarjen.

Gjithashtu, nisi procedimi penal për shtetasit:

-E. H., 44 vjeçe, banuese në Librazhd (bashkëshortja e shtetasit A. H., e cila ka qenë në vendngjarje), për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës",

-S. M., 46 vjeç, banues në Librazhd, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kukës

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rëndа të DVP Kukës ekzekutuan vendimin penal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shtetasin D. S., 25 vjeç, banues në Tropojë, i cili është dënuar me 7 vjet burgim, për veprën penale "Plagosja e rëndë me dashje".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store